



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 173/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Vlastimir Dimić kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Kaçanik, për shkak të vendosjes së posterave në vendet publike, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 18.06.2012, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 14.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me 14 qershor 2012 në Kaçanik, Bulevardi “ Ismajl Raka” në objektin e shtëpisë së kulturës, militantë të AAK-së kanë vendosur poster të kandidatit të tyre për kryetar komune të Kaçanikut Tahir Çaka. Parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2009, dhe Ligji për zgjedhjet e përgjithshme. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografit si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 15.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 16.06.2012, në ora 12:00.

PZAP-i, nuk mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK sipas afatit të caktuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Ankuesi në ankesën e tij pretendon se militantë të subjektit politik AAK kanë vendosur posterat e kandidatit të tyre për kryetar komune në objektin e shtëpisë së kulturës. PZAP-i konstaton se pretendimet e tilla ankimore janë të pabazuar pasi që nga fotografit e ofruara si dëshmi të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk dihet se ku janë të vendosura këto postera dhe se fotografit e ofruara nuk e identifikojnë

objektin për të cilin pretendohet se është shtëpia e kulturës, andaj një pretendim i tillë u vlerësua si përgjithshëm dhe i pa argumentuar në prova dhe dëshmi bindëse, prandaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 173/2012 më datën 18.06.2012

